



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 94/1 Prot

Tiranë, më 28/1/2016

Lënda: *Përgjigje lidhur me "Marrëveshjen për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen për përhapjen e të dhënave personale të studentëve nga Agjencia Kombëtare e Provimeve të Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik për vitin akademik 2015-2016", dërguar në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore.*

Drejtuar: **Znj. Rezana VRAPI**
Drejtore e Përgjithshme
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE (AKP)

Tiranë

E nderuar Znj. Vrap, e

Në vazhdim të komunikimit të mëparshëm, e vlerësojmë angazhimin tuaj në kuadër të respektimit të detyrimeve ligjore referuar Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar përgjigjes tuaj, nr. 102/1 prot, datë 20.01.2016, nëpërmjet të cilës informoni Zyrën e Komisionerit mbi ndryshimet e implementuara në marrëveshje, vlerësojmë se janë realizuar në tërësi sugjerimet e dhëna nga ana jonë, por shprehim rezerva sa i përket afatit të mbajtjes së të dhënave personale nga autoriteti marrës "Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik".

Në nenin 3 të marrëveshjes së ndryshuar (bashkëlidhur përgjigjes tuaj) ju parashikoni se "QNSHRRT-së i jepet e drejta e mbajtjes së të dhënave personale të përhapura për një afat të pacaktuar".

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky parashikim është në kundërshtim me nenin 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Të dhënat personale nuk mund të përpunohen dhe të mbahen për një afat të pacaktuar. përkundrazi duhet të përpunohen dhe të mbahen për sa kohë ekziston qëllimi i përpunimit. Referuar titullit të marrëveshjes së nënshkruar, afati i vlefshmërisë së marrëveshjes është viti akademik 2015-2016.

Pra, në këtë kuadër në rastin specifik do sugjeronim që është vetë marrëveshja që specifikon afatin e mbajtjes së të dhënave që lidhet me qëllimin e përpunimit (periudha 2015-2016). Në rast se nuk keni një parashikim ligjor specifik që ju lejon të mbani në mënyrë të pacaktuar të dhënat personale, është e nevojshme që palët në marrëveshje të parashikojnë një afat specifik të mbajtjes së tyre nga autoriteti marrës, duke specifikuar gjithashtu edhe çfarë ndodh me të dhënat pas përfundimit të afatit.

Gjithsesi, palët janë të lira në përcaktimin e afatit të përpunimit të të dhënave personale me kushtin që afati të jetë i specifikuar.

Zyra e Komisionerit shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe asistuar institucionet tuaja me qëllim garantimin e një procesi të ligjshëm përpunimi të të dhënave personale.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

